



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.4/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtorin profesional Malsor Kryeziu, në kontestin e paditësit KEK – Sh.A. – Divizioni i Furnizimit - Distrikti në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson Y. M. nga Prizreni, kundër të paditurit DPT “M.S.M.” pronar Sh.N., nga Prizreni, rr.”.... ..” nr. .. , me objekt të padisë borxh, vlera e kontestit 1.192,06 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 28.10.2013, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit KEK-Distrikti në Prizren, dhe i padituri DPT “M. S. M.” pronar Sh.N. , nga Prizreni, **OBLIGOHET** që në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike, paditësit ti paguaj shumën prej 1.192,06 euro, me kamatë ligjore prej 3.5%, kamatë vjetore, duke filluar nga data 14.02.2011, deri në pagimin përfundimtarë, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të kësaj procedure, paditësit të ia paguaj shumën prej 20.50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

E autorizuar e paditësit gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ka deklaruar se sipas transaksionit të fundit të konsumatorit të datës 21.01.2011 borxhi i të paditurit është në shumën prej 1.192,06 euro dhe i ka propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara në padi të merr aktgjykim me të cilin do të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e precizuar e paditësit si e bazuar dhe të obligohet i padituri që në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike ti paguaj paditësit shumën prej 1.192,06 euro, me kamatë ligjore prej ditës së parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare. E autorizuar e paditësit ka kërkuar shpenzimet procedurale në shumën prej 20.50 euro, për taksën e paguar për parashtrimin e padisë si dhe shpenzimet gjyqësore për vendimin gjyqësor, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas

plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë leximin e faturës nr. . /..../ . nga Divizioni i furnizimit të datës 06.02.2011, leximin e transaksionit të konsumatorit DPZ-..... të datës 08.05.2013.

Gjykata pas vlerësimit të deklaramentit të palëve në procedurë dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Me leximin e provave si: Leximin e faturës nr. . /..../ . nga Divizioni i furnizimit të datës 06.02.2011, leximin e procesit të Distribucionit në Prizren nr. , të datës 14.05.2004, leximin e transaksionit të konsumatorit DPZ-..... të datës 08.05.2013, gjykata vërteton faktin se i padituri i ka obligim që në emër borxhit për shfrytëzim të energjisë elektrike ti paguaj paditësit shumë prej 1.192,06 euro.

Me nenin 17 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) – i aplikueshëm Ligji Nr.3/3/1978, është paraparë se **“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”**, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se **“kreditoret në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”**.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 17 dhe 262 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.4/12 me datë 28.10.2013

Bashkëpunëtori profesional
Malsor Kryeziu

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.